


DIENËT MUJOR
**NËNTOR
2022**



**VIZITA ZYRTARE E MINISTRIT FEDERAL TË
GJERMANISË PËR BUJQËSINË DHE USHQIMIN**



Vizita e Ministrit Cem Özdemir është padyshim shenjë mbështetje e Gjermanisë për një partneritet ndaj zhvillimit të një bujqësie të qëndrueshme, si dhe mbështetje ndaj Shqipërisë për antarësimin në BE.

JAVA E ULLIRIT: MARATONË AKTIVITETESH

U zhvilluan disa aktivitete në Tiranë dhe Vlorë me prodhues, përpunues, njohës të kësaj kulture, ekspertë të ftuar nga Ambasada Italiane, nga Universiteti i Bolonjës, UBT, Qendra e Transferimit të Teknologjive, shefa kuzhine shqiptarë dhe agroturizma që promovojnë ushqimin shqiptar, ku diskutuam për një mori iniciativash të zhvillimit të ullirit, si dhe si t'i bëjmë jehonë prodhimit fantastik të ullirit që rritet mjaft cilësisht në vendin tonë.

**SESIONI I 45-TË I KOMISIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR PESHKIMIN
NË VENDET E MËSDHEUT**

Shqipëria përmes MBZHR mban presidencën aktuale të GFCM ku është anëtare që nga viti 1991. Peshkimi është një nga sektorët më vitalë të ekonomisë shqiptare, me trend në rritje të eksporteve. Po punojmë për përmirësimin e infrastrukturës së porteve, me mbështetjen e Projektit Blu Economy, për ndërtimin e tregjeve të peshkimit në Durrës dhe Sarandë dhe 7 vende zbarkimi në mbështetje të peshkimit në shkallë të vogël përgjatë vijës bregdetare dhe në liqenet kryesore.



**MOTI I KEQ: GJITHË STRUKTURAT E MBZHR PRANË FERMËRËVE
DHE BLEGTORËVE**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe gjithë strukturat e saj, në terren me misionin e rëndësishëm për t'i ardhur në ndihmë situatës së krijuar për shkak të rreshjeve të shtuara në qarkun Shkodër dhe Lezhë, ku vetëm në Shkodër, sasia rreshjeve arriti mbi 460 mm, pothuajse sa dyfishi i sasisë mujore në vetëm disa ditë. U angazhua i gjithë shteti - ekipet e emergjencave, prefektura, bashkitë, OSHEE etj., për të përballuar dhe normalizuar një situatë të pazakontë në një kohë të shpejtë në ndihmë të qytetarëve.



**RRITEN EKSPORTET BUJQËSORE
TË 10 MUJORIT 2022**



Vazhdon rritja e konsoliduar e eksporteve bujqësore në 10 mujorin e vitit 2022. Në 10 mujorin e vitit 2022, kemi një rritje të eksporteve shqiptare me 20.8% në vlerë dhe 16.8% në sasi. Konkretisht, në periudhën janar-tetor janë eksportuar rreth 63.5 milionë euro më shumë ose 50 mijë ton më shumë.

**MIRATOHET NË KUVEND LIGJI PËR
BUXHETIN 2023: 12% MË SHUMË
BUXHET PËR BUJQËSINË**

Fondi për bujqësinë arrin në 14.2 miliardë lekë me një rritje 12% krahasuar me atë të këtij viti. Ky është buxheti më i madh i paradhikuar ndonjëherë, në mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ai adreson mbështetje për 7 programe dhe synon rritjen e sigurisë ushqimore, qëndrueshmërinë e turrizmit rural, digjitalizimin dhe inovacionin.

BUXHETI 2023



TOTAL 14.2 MLD LËKË

SHQIPËRIA MERR PRESIDENCËN E CIHEAM



Hera e parë që Shqipëria zgjidhet në krye të Bordit Drejtues të Qendrës Ndërkombëtare për Studime të Avancuara Agronomike Mesdhetare, një organizatë që për 60 vjet kontribuon për të promovuar kooperimin multilateral mesdhetar në fushat e bujqësisë, të ushqimit, peshkimit dhe menaxhimit të territoreve rurale, duke patur si qëllim t'i përgjigjet nevojave të shteteve dhe aktorëve të agro-ushqimit. Delegacionet e 13 shteteve anëtare të organizatës, në mbledhjen e 151-të që u mbajt në Institutin Oqeanografik të Parisit (Francë) nominuan kandidaturën e Shqipërisë.

DIPLOMIMI I 1650 STUDENTËVE TË UBT-SË

Një festë të madhe me prindër, profesorë, studentë dhe të ftuar në Ceremoninë e Diplomimit për studentët. 1 në çdo 4 student të UBT është i punësuar me kohë të plotë gjatë periudhës së studimeve 14% e tyre janë të vetëpunësuar në biznesit e tyre, dhe 1 në 3 studentët është i punësuar me kohë të pjesëshme. Një vit pas përfundimit të studimeve 2 në 3 studentë janë të punësuar me kohë të plotë ose të vetëpunësuar ndërsa vetëm 1 në 5 studentë nuk ka gjetur akoma punë.